

**RAPORTI I
DËGJIMEVE
BUXHETORE
PËR PLANIFIKIMIN E
PROJEKT-BUXHETIT
PËR VITET 2025-2027**



**KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN**





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 24. 09 2024		
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtet, ca Dodatak
01-052/01-47117		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e kryetarit të komunës

Datë:	24.09.2024
Për:	Z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	Z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës Z. Latif Ramadani – Drejtor për Buxhet dhe Financa
Nga:	Zyra për Informim
Lënda:	Raporti i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e projekt-buxhetit për vitet 2025-2027

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 paragrafi 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, përfaqësuesit nga komuna, konkretisht nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kanë mbajtur dëgjime publike për Planifikimin e Buxhetit për vitet 2025-2027 me qytetarët e vendbanimeve të ndryshme të Lipjanit.

Përmbajtja

1. Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit 2025-2027..	4
2. Ecuria e procesit.....	5
3. Dëgjimi Buxhetor me Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe Komitetet tjera.....	6
4. Dëgjimi Buxhetor me gratë dhe shoqatat e grave.....	9
5. Dëgjimi Buxhetor me organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit.....	10
6. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave.....	11
7. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Gadimes.....	12
8. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Ribarit të Madh.....	13
9. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Shalës.....	14
10. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Grackës së Vjetër – komunitetet jo shumicë.....	15
11. Dëgjimi Buxhetor nga kuvendi me kuvendaret, anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të dhe kryetarët e këshillave të fshatrave.....	16
12. Konkluzionet.....	17



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË
PROJEKT BUXHETIT 2025-2027**

Neni 1

Përbërja

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025-2027, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Ismet Haziri, Zyrtar në Drejtoratin për Arsim, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

Neni 2

Detyrat e grupit punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025-2027 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbale dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2025-2027 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/01-26865
Lipjan, më 31.05.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhim me Platformën e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit, në harmoni me ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, ka publikuar në faqen e internetit të komunës njoftimin lidhur me orarin e mbajtjes së këtyre takimeve, si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit në facebook, shih linket. ↓

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore KAB, 2025-2027

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/08/Degjimet-Buxhetore-per-Planifikimin-e-Buxhetit-2025-2027.pdf>

<https://www.facebook.com/komunalipjan/posts/pfbid04Sd7R7mpp1CDpHr6UWU1QzWKpZt8kc17yZpB4uYZprmQURn6XgZTxFM4GLrZQ9E3I>

<https://www.facebook.com/komunalipjan/posts/pfbid0297TqJWcjjZjlclhYWyD2vKP5i1MkH6qZWjVCtHwrrp2xb5WHCyihpeWD4qBjCzhsRI>

Po ashtu, në faqen e internetit tek konsultimet publike, është publikuar edhe projekt-buxheti, ku qytetarët kanë pasur mundësi të japin komentet lidhur me Planifikimin e projekt-buxhetit për vitet 2025-2027.

Shih linkun ➡ https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page_id=200034772

Njoftimi për diskutim publik është shpallur në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna. Po ashtu, palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën për mbajtjen e takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik projekt-buxheti për vitet 2025-2027.

Dëgjimi i parë publik lidhur me planifikimin e buxhetit është mbajtur me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë e Financa, Komitetin për Komunitete, dhe komitete të tjera. Pastaj ka vazhduar me fokus grupet e veçanta si: Gratë dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, dhe fermerët e Komunës së Lipjanit. Ndërsa dëgjimet kanë vazhduar me banorët e qytetit të Lipjanit, kryetarët e këshillave të fshatrave dhe me banorët e fshatit Gadime, më pas është vazhduar me organizimin e dëgjimeve buxhetore në fshatrat Ribar i Madh, Shalë, dhe Grackë e Vjetër (komunitetet jo shumicë).

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, para të pranishmëve fillimisht ka elaboruar projekt-buxhetin për vitet 2025-2027 dhe ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dalë nga këto takime. Ai po ashtu ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime, sepse kanë rëndësi të veçantë dhe janë mundësia më e mirë për përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme.

Ndërsa Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi, ka organizuar një dëgjim të veçantë buxhetor me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, komitetet e tjera përcjellëse të kuvendit komunal, shoqërinë civile si dhe kryetarët e këshillave të fshatrave, me të cilët ka bashkëbiseduar rreth projekt-buxhetit për vitet 2025-2027.

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitet, si dhe Komitetet tjera".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Sa është buxheti këtë vit për kategoritë mallra dhe shërbime, dhe sa ka ndikuar rritja vetanake në këto kategori? 2. Kërkoj zgjerimin e kanalizimit në vendet ku nuk ka kanalizim? 3. Ujësjiellës sidomos për e Janjevë? 4. Zhavorrimi i rrugëve të arave në Janjevë? 5. Laboratorë dhe kabinete në shkolla të cilat nuk kanë? 6. Ujësjiellës për Ribar, Kraisht, Bujan, Topliqan? 7. Ndërtimi i një shkolle fillore në qytet? 8. Rikonstruktimi i rrugës Kojsko – Topliqan? 9. Rruga Rufe i Vjetër - Hallaq i Vogël duhet të futet në buxhet për ndërtimin e saj së bashku me urën? 10. A është prapa ndërtimi i shtëpisë së kulturës? 11. Rikonstruktimi i rrugës Lipjan - Rubofc i Madh, së bashku me shtegun e ecjes dhe biçikletave? 12. Ndërtimi i fushës sportive në Rubofc të Vogël? 13. Rritja e bursave për studentët? 14. Mirëmbajtja e varrezave dhe ndriçimit publik? 15. Të ndërtohet trotuari në Kraishtë?	1. Buxheti për këtë vit është 24,897,038 milionë, të hyrat vetanake kanë ndikuar pasi që është ngritur tavani i të hyrave. 2. Kërkesa është pranuar në planifikimin e projektbuxhetit, është paraparë zgjerimi i kanalizimit në disa vendbanime. 3. Është kompetencë e KRU-Prishtina pasi që Komuna e Lipjanit nuk menaxhon me këtë ndërmarrje. 4. Kërkesa është pranuar pasi që rrugët e kategorisë së tretë do të zhavorrohen përmes kontratës për zhavorrim të rrugëve. 5. Edhe pse shumica e shkollave janë të pajisura me laboratorë, në rast se ka shkolla që nuk kanë, do të shikojmë përmes donatorëve që të pajisen me to. 6. Kërkesa është pranuar, por ky projekt është duke u realizuar me CDI-zvicerane, por i cili aktualisht i ka pezulluar punimet. 7. Kërkesa është pranuar, jemi në pritje të përfundimit të ndërtimit të shkollës së re tek shkolla Adem Gllavica, ku do të barten nxënësit e gjimnazit dhe objekti i gjimnazit do të jetë shkollë fillore. 8. Kërkesa e pranuar do të shikohet përmes donatorëve për të rikonstruktimin e rrugës Kojske-Topliqan. 9. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë investime në rrugën Rufe i Vjetër - Hallaq i Vogël. 10. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë ndërtimin e qendrës multifunksionale në qytetin e Lipjanit. 11. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit në projektbuxhetin ka paraparë rikonstruktimin e rrugës Lipjan-Rubofc. 12. Kërkesa e pranuar, Komuna e	F M T 4 13 17	27.08.2024 Salla e Kuvendit Komunal Ora 13:30

	16. Zgjerim të kanalizimit për fshatin Ribar i Madh? 17. Rikonstruktimi i rrugës Ribar – Poturovc? 18. Të rritet buxheti për subvencionet në bujqësi?	Lipjanit përmes donatorëve do të shikojë mundësinë e ndërtimit të fushës në Rubofc të Vogël. 13. Komuna e Lipjanit çdo vit ka ndarë bursa për studentë dhe çdo vit është rritur numri i përfituesve të bursave. 14. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit ka kontratë për mirëmbajtjen e varrezave, si dhe të ndriçimit publik. 15. Kërkesa e pranuar, në fshatin Kraishtë është paraparë të ndërtohet trotuari. 16. Kërkesa e pranuar, përmes kontratës kornizë do të bëhet zgjerimi i kanalizimit. 17. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë investim në rikonstruktimin e rrugës Ribar i Madh – Poturovc. 18. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka ndarë subvencione për bujqësi.	
--	--	--	--




Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitet, si dhe komitetet tjera".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Gratë dhe shoqatat e grave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	- Kërkoj të hapet një treg sezonal, ku gratë që merren me produkte ushqimore dhe artizanale t'i shesin produktet e tyre. - Kërkoj që të ndahen subvencione për gratë, që të organizohen panairë, të cilat do t'i ndihmonin gratë t'i shesin produktet e tyre.	- Kërkesa e pranuar, varësisht nga kërkesat, Komuna e Lipjanit çdo vit organizon panairë të cilat kanë për qëllim t'i ndihmojnë gratë që kanë biznese të ushqimeve tradicionale, me qëllim të krijimit të mundësisë për promovimin dhe shitjen e produkteve të tyre. - Kërkesa e pranuar. Komuna e Lipjanit, së bashku me donatorët, vazhdimisht ka përkrahur kërkesat për organizimin e panairëve për promovimin dhe shitjen e produkteve të ndryshme të prodhuara nga bizneset e grave.	F M T 22 5 27	27.08.2024 Salla e Kuvendit Komunal Ora 14:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Gratë dhe shoqatat e grave".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Organizatrat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Kërkoj që të rregullohet çështja e ujërave të zeza në lumin Kojске, konkretisht te ura, aty ku është ndërtuar hekurudha, ku pjesa e betonit poshtë ka mbetur më e ngritur dhe si pasojë po krijon grumbullim të ujërave të zeza. 2. Kërkoj po ashtu që deponia e mbeturinave, e cila gjendet afër shtigjeve të ecjes, të largohet dhe të pastrohet vendi aty, dhe të dërgohen mbeturinat te lokacioni i përcaktuar edhe me rregulloren e komunës. 3. Sa janë subvencionet në Drejtorinë e Kulturës për vitin 2025? 4. Të ndahen subvencione të veçanta për gratë që merren me aktivitete ekonomike apo gratë që merren me biznes. 5. Të subvencionohen gratë jehonë ose gratë vetushqyese, ose të krijohen lehtësira. 6. Kërkoj që të mirëmbahet fusha sportive që janë ndërtuar. 7. Te qendra Better Life të rregullohen dëmtimet që janë bërë nga qytetarët e pandërgjegjshëm. 8. Në Magurë, te banesat e demoluara, të ndërtohet një park dhe të pyllëzohet ajo pjesë. 9. Kërkoj që të pastrohet trotuari në fshatin Gillogoc.	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit do ti kërkoj kompanisë e cila e ka shkaktuar demin që ta rregulloj, pasi që në rastin në fjalë demin e ka shkaktuar kompania e menaxhimit të hekurudhave. 2. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit, sipas rregullores që ka përcaktuar vendin për zhvendosjen e deponisë, është duke e zhvendosur këtë deponi në parcelën e destinuar për deponi. 3. Subvencionet në Drejtorinë e Kulturës, Rini dhe Sportit për këtë vit arrijnë në 250 mijë euro. 4. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me donatorët, vazhdimisht ka përkrahur gratë që merren me biznes. 5. Kërkesa është pranuar, në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë, përmes kategorisë së subvencioneve mbështetën varësisht nga kërkesa. 6. Kërkesa është pranuar, Komuna ka kontratë për mirëmbajtjen dhe vazhdimisht i ka sanuar dëmtimet në këto fusha. 7. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit veçse i ka sanuar dëmet që janë shkaktuar te qendra Better Life. 8. Komuna e Lipjanit, së bashku me donatorët, ka	F M T 4 11 15	27.08.2024 Salla e Kuvendit Komunal Ora 15:30

	10. Të ndërtohet një rreth rrotullim ose të vendosen semaforë te shkolla Mehmet Akif, në udhëkryqin e magjistrales Prishtinë-Ferizaj dhe rrugës Smallush-Glllogovc.	paraparë investim në këtë zonë, ku do të ndërtohet një park te ish-banesat e rrënuara në Magurë. 9. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit, përmes kontratës për mirëmbajtje, do ta pastrojë trotuarin në Glllogoc. 10. Kërkesa nuk pranohet, pasi që komuna e Lipjanit nuk ka kompetencë të investojë në rrugët të cilat menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës në nivelin qendror.		
--	--	---	--	--



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Organizatrat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive dhe fermerët e Komunës së Lipjanit".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Të rikonstruktohet rruga "Kreshnik Vishësella" ndërmjet Ribarit të Vogël dhe Ribarit të Madh. 2. Kërkesa tjetër është të ndërtohet një park te fusha sportive? 3. Kërkoj që të shtrohen rrugicat që kanë mbetur në fshatin Miren? 4. Kërkoj të vazhdohet kanalizimi në fshatin Miren? 5. Të ndërtohet trotuar në rrugën e Martirëve të Mirenës, e cila shkon për Blinajë?	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë në projektbuxhet rikonstruimin e rrugës Ribar i Vogël – Ribar i Madh. 2. Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit do ta shqyrtoj kërkesën përmes donatoreve. 3. Pjesa më e madhe e rrugicave janë asfaltuar, përveç rrugicave që kanë pasur probleme pronësore. 4. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë ndërtimin e kanalizimit në Miren. 5. Kërkesa refuzohet, nuk ka hapësirë për ndërtimin e trotuarit, ka probleme pronësore dhe duhet shpronësim.	F M T 0 6 6	27.08.2024 Salla e Kuvendit Komunal Ora 17:00




Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Qytetarët e Gadimes".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Kërkoj që të asfaltohen rrugicat në lagjen Ejupi në Gadime të Ulet deri të rruga mes Gllavices dhe Gadimes së Epërme 2. Vazhdimi i trotuarit nga lagja e Ibraj dhe ndriçimi publik te lagja e Stubllave? 3. Të asfaltohet rruga Njazi Isufi? 4. Pse është ndërprerë rregullimi i lumit? 5. Kërkoj që rruga 6 Maji të bëhet me ndriçim publik, diku 700 metra kanë mbetur pa ndriçim publik?	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit në projektbuxhet ka paraparë asfaltimin e rrugicave në lagjen Ejupi në Gadime të Ulet. 2. Kërkesa refuzohet pasi që ka probleme pronësorë dhe kërkohet shpronësim. 3. Kërkesa refuzohet pasi që ka problem pronësorë dhe kërkohet shpronësim 4. Komuna e Lipjanit ka ndërprerë kontratën me operatorin e përgjegjshëm për ndërtimin e lumit në Gadime, por ndërtimi i tij do të vazhdojë pasi Komuna e Lipjanit e ka paraparë në projektbuxhet ndërtimin e lumit në Gadime. 5. Kërkesa pranohet përmes kontratës kornizë do të shikohet mundësia e zgjerimit të ndriçimit publik.	F M T 0 16 16	27.08.2024 Shkolla fillore "Zenel Hajdini", Gadime Ora 19:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Gadimes".

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit 2025-2027 ka vazhduar më datën 28.08.2024 me banorët e fshatrave Ribar i Madh dhe Shalë. Ndërsa më datën 29.08.2024 ka vazhduar organizimi i dëgjimeve buxhetore në fshatin Grackë e Vjetër (komuniteti jo shumicë).

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, gjatë takimeve ka bashkëbiseduar me banorët e këtyre lokaliteteve për planifikimin e buxhetit 2025-2027 dhe ka marrë në konsideratë kërkesat dhe prioritetet për të cilat qytetarët e këtyre fshatrave kanë më shumë nevojë, në mënyrë që të përfshihen në planifikimet buxhetore.

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Qytetarët e Ribarit të Madh".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Kërkoj mirëmbajtjen dhe zgjerimin e kanalizimit në Ribar të Madh? 2. Kërkoj të rikonstruktohet rruga Ribar i Madh – Poturovc? 3. Të zhavorrohen rrugët e arave? 4. Të rregullohet oborri i shkollës fillore dhe të ketë kënde lojërash?	1. Komuna e Lipjanit nuk ka kompetencë për mirëmbajtjen e kanalizimit, pasi që sistemi i kanalizimit dhe ujësjellësit janë përgjegjësi e kompanisë rajonale të ujësjellësit. 2. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë rikonstruktimin e rrugës Ribar i Madh – Poturovc. 3. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka kontratë për zhavorrimin e rrugëve të arave, ku aktualisht veçse ka filluar zhavorrimi i këtyre rrugëve. 4. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë ndërtimin e këndeve të lojërave në shkollat e komunës së Lipjanit.	F M T 0 20 20	28.08.2024 Shkolla fillore "Kadri Beba", Ribar i Madh Ora 17:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Ribarit të Madh".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Qytetarët e Shalës".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Kërkoj të ndërtohet trotuari nga sheshi deri te shkollat fillore? 2. Kërkojmë që të asfaltohen rrugicat e mbetura? 3. Të bëhet zgjerimi i kanalizimit? 4. Të ndërtohet një parking për vetura afër shkollës?	1. Kërkesa nuk pranohet, edhe pse ka trotuar, por në disa pjesët ka probleme pronësore, komuna nuk mund të investojë në pjesët ku ka probleme pronësore. 2. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë në projektbuxhet që të asfaltohen rrugicat në Shalë. 3. Kërkesa pranohet, përmes kontratës kornizë do të bëhet zgjerimi i kanalizimit. 4. Kërkesa pranohet përmes rregullimit të oborreve të shkollave do të shikohet mundësia e rregullimit të parkingut.	F M T 2 12 14	28.08.2024 Shkolla fillore "Shaqir Hoxha", Shalë Ora 19:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Shalës".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Qytetarët e Grackës së Vjetër"
– komunitetet jo shumicë.

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	1. Të asfaltohet një rrugicë brenda fshatit? 2. Të rregullohen disa drita të prishura në hyrje të fshatit?	1. Kërkesa është pranuar, Komuna e Lipjanit ka paraparë në projektbuxhetin e komunës ndërtimin e rrugicave në Grackë të Vjetër. 2. Kërkesa është pranuar, përmes kontratës për mirëmbajtje do të rregullohen dritat që janë të prishura.	F M T 0 4 4	29.08.2024 Shkolla fillore në Grackë të Vjetër Ora 17:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Grackës së Vjetër".

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, ka vazhduar me datën 10.09.2024 me anëtarët e Kuvendit, anëtarët e KPF-së, komitetit për komunitet, komitetet tjera, OJQ-të si dhe kryetarët e këshillave të fshatrave.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi, ka organizuar takim me përfaqësuesit institucionalë për planifikimin e buxhetit 2025-2027, ku ka marrë kërkesat dhe prioritetet për planifikimin e buxhetit komunal. Lista dhe procesverbal i takimit të kryesuesit me përfaqësuesit institucional gjenden në sektorin e Kuvendit Komunal.

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027, me "Anëtarët e kuvendit, Anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027	- Asfaltimi i rrugës Milazim Petrova në lagjen e Akllapit ose, të paktën, zhavorrimi në këtë kohë? - Rregullimi ose renovimi i banesave të qytetit? - Asfaltimi i rrugës Nëna Terezë dhe rrugës Bajram Curri në Lipjan?	- Kërkesa nuk pranohet pasi që ka probleme pronësore, vetëm nëse ka pëlqim me pronarin atëherë mundet që këtë vite të shtrohet me zhavorr përmes kontratës për zhavorrim. - Renovimi i banesave do të bëhet në bashkëpunim me donatorin. - Kërkesa pranohet në projektbuxhet, është paraparë hapja dhe ndërtimi i rrugës Bajram Curri.	F M T 2 12 14	10.09.2024 Salla e Kuvendi Komunal Ora 13:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit, anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të dhe kryetarët e këshillave të fshatrave".

Konkluzionet

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027 reflekton angazhimin e Komunës së Lipjanit për të përfshirë sa më shumë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në planifikimet e ardhshme financiare. Këto takime janë dëshmi e përkushtimit të institucioneve lokale për një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente, duke i dhënë zë grupeve të ndryshme të interesit dhe duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës. Ky projekt-buxhet do të aprovohet në Kuvendin e Komunës së Lipjanit, pastaj dorëzohet në departamentin e buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave.


Kërkesat e qytetarëve janë nga më të ndryshmet, duke përfshirë investime në infrastrukturë si asfaltimi i rrugicave, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve, shtrirja e ujësjellësit dhe kanalizimeve, si dhe investime në sektorin e arsimit. Nga 54 kërkesa, të paraqitura nga qytetarët dhe të shqyrtuara nga komisioni, 48 janë marrë parasysh ose, shprehur në përqindje 88%, prej tyre janë marrë në konsideratë dhe janë të planifikuara në projekt-buxhet, duke reflektuar përpjekjet e zyrtarëve përgjegjës për organizimin e dëgjimeve buxhetore për të balancuar këto kërkesa me kufizimet buxhetore. Kjo tregon angazhimin për t'i dhënë zë shqetësimeve të qytetarëve, duke garantuar një proces transparent dhe të përgjegjshëm.

Pjesa më e madhe e kërkesave të qytetarëve është pranuar, siç janë asfaltimi i rrugicave, ndërtimi i trotuareve, zgjerimi i ndriçimit publik, mirëmbajtja e fushave sportive, zhavorrimi i rrugëve të kategorisë së tretë, zgjerimi i kanalizimit dhe ujësjellësit, si dhe investimi në shkollë dhe në ndërtimin e hapësirave të gjelbra. Gjithashtu, i është kushtuar rëndësi edhe subvencioneve për klubet sportive, OJQ-të dhe aktivitetet kulturore, të cilat do të jenë elemente kyçe të këtij projekt-buxheti.

Në anën tjetër, janë shprehur edhe disa kufizime dhe pamundësi për realizimin e disa projekteve, për shkak të çështjeve pronësore apo kompetencave të ndara mes niveleve lokale dhe qendrore të qeverisjes. Megjithatë, përkundër këtyre pengesave, Komuna e Lipjanit ka treguar vullnet për të vazhduar punën për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Pjesëmarrja e gjerë në këto dëgjime dhe përfshirja e grupeve të ndryshme, si dhe konsultimet e hapura me banorët, evidentojnë rëndësinë e transparencës komunale në proceset vendimmarrëse dhe përmirësimin e jetës në nivel lokal. Ky projekt-buxhet pritet të shënojë një hap të madh përpara në zhvillimin e Komunës së Lipjanit, duke adresuar prioritetet e qytetarëve dhe duke krijuar kushte më të mira për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Numri i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2025-2027 ishte si në vijim: Burra - 99, Gra - 34, Totali - 133 pjesëmarrës nga 9 takimet e realizuara vetëm për planifikimin e Projekt-Buxhetit. Këtij raporti i janë bashkangjitur edhe listat e pjesëmarrësve të dëgjimeve buxhetore.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



















Rr. Shqipëria nr. 28/14000 Lipjan, Kosovë

Asambleja, Komitetet 28.08.24

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Lulzim Buxteu	Lipjan	Lulzim Buxteu
2	Armen Graqev	Dibër i Madh	Armen Graqev
3	Behim Krasniqi	VAHR	Behim Krasniqi
4	Qindër Murgati	Kosovë	Qindër Murgati
5	Rexhep Rexhep	Lipjan	Rexhep Rexhep
6	Art Xhasniqi	VAHR	Art Xhasniqi
7	Elmas Belduli	Drejtoreshë	Elmas Belduli
8	Xhyltene Xhemajli	Praktikante	Xhyltene Xhemajli
9	Xhyltene Xhemajli	Lipjan	Xhyltene Xhemajli
10	Artina Lekçi	Lipjan	Artina Lekçi
11	Florët Hiri	Lipjan	Florët Hiri
12	Kimete Johana	OSCE	Kimete Johana
13	Skender Biliçi	Komitetet	Skender Biliçi
14	Viser Jashari	ICE	Viser Jashari
15	Lotif Ramadan	Dagton i DSE	Lotif Ramadan
16	Imri Jemetic	Lipjan	Imri Jemetic
17	Shahdije Dragëçina	Lipjan	Shahdije Dragëçina
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			









Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Leonida Asllani	Helena Ives	
2	Shahadre Jbrani	Gadime	
3	Laureta Ahmeti	Lipjan	
4	Shehida Jon Balui	Lipjan	
5	Medina Bybika	Lipjan	
6	Albina Gashi	Lipjan	
7	Adelina Rexhepi	Lipjan	
8	Beatrice Buja	Bujan	
9	HYRA BYTYCI	QYLLAGE	
10	Muh'teser Hetaj	Magure	
11	Flora Aliu	Lipjan	
12	Artina Lekici	Gadime e Ulët	
13	Ngjete Xhemajli	Kugaxhi	
14	Herolinda Lekici	Gadime e Ulët	
15	Prit Krasniqi	YAPAR	
16	Belvin Krasniqi	XATK	
17	Tranvera Krasniqi	K. Lipjan	
18	ARRESHA HETEMI	LIPJAN	
19	ALBAN BYTYCI	LIPJAN	
20	Safete Amerllahu	LIPJAN	
21	Saranda Shillova	Topliqan	
22	Liridona Krasniqi Dedushi	Kraishite	
23	Elisa Aliu	Lipjan	
24	Micamden Gashi	Lipjan	
25	Kimete Shkur	OSCE	
26	Ferdion Shok	Lipjan	
27	Lirij Rmendon	Lipjan	
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			



Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Beqim Krasniqi	YAHQ	
2	Art Krasniqi	YAHQ	
3	Elbifon Ibrahim	YAHQ	
4	Vosa Gashi	POCIS	
5	Muhamet Qeriqi	D+	
6	AFRIM MENA	HANDIKOS	
7	Kimete Ishani	OSCE	
8	Vitet Topaj	ECF Mj	
9	Enat Ramadani	Lipjan	
10	URAN QERIQI	Lipjan	
11	ARBRESHA HETEMI	LIPJAN	
12	PRANVERA KRANIQI	K. LIPJAN	
13	LEONITA BUBLICA	K. LIPJAN	
14	Behim Zerkani	Lipjan	
15	Ferdian Shala	Lipjan	
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

Nr	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Hysnet Kelmexhi	Qiborivogel	
2	Gëzim Fozliu	Ureni	
3	Art Kreniqi	YAH2	
4	Behim Krasniqi	YAHK	
5	Jevorian Shqk	Lipon	
6	Art Ramadani	Shqk	
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

Nr.	Emri Mbiemri	Vendi	Nenshkrimi
1	Sead Aliu	Gadime	Aliu
2	Belum Krasneri	WATER	Aliu
3	Rihard Sahiti	Gadime	Aliu
4	ARBEN HYSENI	SIADIME	Aliu
5	Imet Dibrani	GADIME	Aliu
6	MALIQ SHABANI	GADIME	Aliu
7	ISMAJL AGUSHI	GADIME G.	Aliu
8	Arben Isufi	GADIME - GP	Aliu
9	RITGIDO HALIM	GADIME GP	Aliu
10	HYZRI AGUSHI	GADIME GP	Aliu
11	HAHRI MAHMUTI	GADIME	Aliu
12	Hasan Gashi	Gadime GP	Aliu
13	Asaj Gashi	Gadime	Aliu
14	Rexhep Rexhep	Gadime	Aliu
15	BEKIM SHABANI	GADIME	Aliu
16	Jerdion Shale	Lipjen	Aliu
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

Nr.	Emri Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	Armend Grajçevci	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
2	Rizart Durici	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
3	Mosir Hoxha	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
4	Labinot Hoxhani	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
5	Edonis Vesiqi	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
6	Armend Durici	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
7	Thyberi Hoxhi	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
8	Bethi Z. Kozhani	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
9	Bekir KRASHICA	YAHK	<i>[Signature]</i>
10	Jerdion Shuka	Zigjon	<i>[Signature]</i>
11	Muzy Hoxhani	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
12	Sylejmon Blloccy	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
13	SHENSI DURECI	RIPAR, Madh	<i>[Signature]</i>
14	Nehat Torgjer	RIPAR, Madh	<i>[Signature]</i>
15	Lotif Romdhani	RIPAR, Madh	<i>[Signature]</i>
16	Aliu Grajçevci	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
17	Flis Durici	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
18	Nagip Grajçevci	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
19	Edonis Vesiqi	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
20	Dechir Hoxhani	Ribar i Madh	<i>[Signature]</i>
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

Nr.	Emri Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	Fatim Ademi	Shale	
2	Muslim Selimi	Shalë	
3	Fidan Hoxha	Shalë	
4	Minator Hoxha	SHALË	
5	Ali Shamolli	Shale	
6	Xhyle Kopyci	Shalë	
7	Bleriana Kadrioli	Shalë	
8	Leotrim Pajzibi	Shalë	
9	Belim Krasniqi	YAHK	
10	Hamend Gjepali	Lipja	
11	Isuf Shale	Lipja	
12	Ferdion Shale	Shale	
13	Edmond Hoxha	Shalë	
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

Nr.	Emri Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	Zoran Cirković	Mala Gracka	
2	Jovan Matović	Mala Gracka	
3	Zulzim Qerimi	Grackë e Vjetër	
4	Naser Bydygi	Grackë e Vjetër	
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			

SALLËN E KUVENDIT ME FILLIM NË ORA 15,⁰⁰

[illegible]